



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 165 / 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković. – Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt: 20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 05 Maj 2019, të parashtruar nga OE- “Aroma Plus”shpk , për tërheqje të ankesës së dt: 12.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Budi, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevari” me nr. prokurimi: “616-19-629-2-1-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtina” me datën 06.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, kërkesa e datës: 05 Maj 2019, e parashtruar nga operatori ekonomik “Aroma Plus”shpk për tërheqjen e ankesës me nr. 165 /19, të datës: 12.04.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Budi, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevari” me nr. prokurimi: “616-19-629-2-1-1-1”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues / “KK-Prishtina”

II. I LEJOHET autoritetit kontraktues “KK-Prishtina” që të vazhdoj me tutje me procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Budi, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevari” me nr. prokurimi: “616-19-629-2-1-1-1”,

III. Meqenëse parashtruesi i ankesës tërhiqet nga ankesa dhe pretendimet ankimore, si dhe duke u bazuar në nenin 30.2 të Rregullores së punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

IV. Obligohet, OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik “Aroma Plus”shpk, ka parashtruar ankesë në OSHP me datën: 21.04.2019 nr. 165/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Budi, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevari” me nr. prokurimi: “616-19-629-2-1-1-1”, të zhvilluar nga Autoriteti “KK-Prishtina”, duke pretenduar në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së, 10 dhe 28 të LPP-së

Me datën: 12.04.2019, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja, për pranimin e ankesës së lartpërmendur lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Budi, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevari” me nr. prokurimi: “616-19-629-2-1-1-1”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtina”

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.04.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 26.04.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “Aroma Plus”shpk në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, gjatë përpilimit të specifikave teknike nuk janë cekur sasitë për materialin e kërkuar me qëllim që OE të kenë një vlerësim më të drejtë për ofertat e tyre, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Është e drejtë e Autoritetit Kontraktues të përpilojë specifikat teknike në përputhje me qëllimet e prokurimit, andaj AK si njësi matëse të çmimit ka përcaktuar sipërfaqen e objekteve shkollore (metër katror) dhe numrin e punëtorëve duke konsideruar që kontrata është për shërbime dhe në aneksin e specifikimeve teknike janë paraqitur disa mostra për realizimin e shërbimeve. Në faqen 23 të Dosje së Tenderit tek “materiali për mirëmbajtjen e higjienës” janë dhënë disa mostra të

materialit të cilat OE duhet t'i përdor gjatë mirëmbajtjes së objekteve shkollore. Sasitë e secilit material/mostra të nevojshëm për metër katror të sipërfaqes së objektit nuk janë të përcaktuara në DT por kjo mbetet të vlerësohet nga vet OE. Tek kontratat për shërbime nuk mund të përcaktohen sasitë si në rastin konkret, prandaj nuk ka shkelje të ndonjë neni të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e dytë nga OE se kur behët fjalë për pagesën e përvojës ka paqartësi rreth asaj se pagesa e përvojës së punës a duhet të jetë me TVSH apo pa TVSH konsiderojmë se përvoja e punës është pjesë e pagës bazë dhe në total TVSH duhet të kalkulohet edhe për pagën Bruto edhe për pjesën e përvojës së punës.

Konstatojmë se të dy pretendimet ankimore janë të **pabazuara**

Gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues në përgjithësi ka respektuar dispozitat e ligjit të prokurimit publik. Eksperti shqyrtues gjatë analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimor nuk ka vërejt ndonjë shkelje të dispozitave të LPP-së të cilat e dëmtojnë procesin e prokurimit.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **refuzohet** për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimeve ankimore të më sipërme. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së mbetet pranë vendimit të AK "KK Prishtina" të datës 12.04.2019 lidhur për **anulimin** e aktivitetit e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frashëri, Pjetër Bogdani, Shkolla e Gjelbër dhe Mehmet Xhevari" me nr. prokurimi 616-19-629-2-1-1 të iniciuar nga AK-"KK Prishtina" në bazë të dispozitave të LPP-së

Përfaqësuesi i OE ankues me datën: 05.05.2019, ka dërguar në adresë të OSHP-së e-mail, ku ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, me nr. 165 / 19, lidhur me tenderin me titull "Pastrimi i shkollave fillore Gjergj Fishta, Ismajl Qemajli, Asim Vokshi, Dardania, Naim Frasheri, Pjeter Budi, Shkolla e Gjelber dhe Mehmet Xhevari" me nr. prokurimi: "616-19-629-2-1-1", të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "KK-Prishtina", me arsyetimin në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 dhe 1 i Rregullores Nr. 01/2017 të Punës se OSHP-se, tërhiqemi nga ankesën, pra nga shqyrtimi i mëtejshëm për arsye se nuk kemi interes juridik.

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankues “Aroma Plus”shpk dhe të gjitha provave që gjenden në lëndë ka vendosur që ta aprovoj kërkesën në fjalë si të arsyeshme.

Paneli shqyrtues, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK-Prishtinë

1x1 OE “Aroma Plus”shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.